

VENDIM
Nr. 14, datë 28.9.2023

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH

Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, të kreut I, nenit 22, pika 4, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, i ndryshuar, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhër urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023, të kryetarit të Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në AIDSSH”, i ndryshuar, me urdhrin nr. 56, datë 23.3.2023, “Për një ndryshim në urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023 ‘Për krijimin e komisionit të deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, me vendimin nr. 14, datë 28.9.2023, si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Fondi Instituti, Bazat teorike të shërbimit sekret të OSSH-së, me 4 volume në total me 585 (pesëqind e tetëdhjetë e pesë) fletë. Dosja daton në vitin 1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

1. Arsyeja e deklasifikimit të dokumenteve të sipërcituara, është:

- Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nenin 22, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, si dhe në vendimin e Autoritetit nr. 31, datë 24.1.2023, pika 1 e dispozitivit.

2. Ngarkohet Sekretari i KDZH-së, të bëjë evidentimet përkatëse në regjistër, të vendosë vulën përkatëse mbi dokumentet e deklasifikuara dhe të hartojë bibliografinë e informacionit të deklasifikuar.

3. Kopja e bibliografisë së informacionit të deklasifikuar , t’i dërgohet zyrtarisht Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar.

4. Të bëhet publikimi i dokumenteve të deklasifikuara në faqen zyrtare të internetit të AIDSSH-së dhe në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR I KOMISIONIT
TË DEKLASIFIKIMIT DHE ZHVLERËSIMIT
Gentiana Sula